

Vendim nr. 181, datë 04.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Asim Vokshi,	Anëtar

në datën 04.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (G) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **GENC BOGA**, përfaqësuar nga avokatët Gerhard Velaj dhe Besmir Iljazi, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-4494 (614), datë 13.11.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 45, 49, pika 3, shkronja “e”, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*)

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Asim Vokshi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi, në cilësinë e punëdhënësit të zyrës juridike “*Boga & Associates Attorneys at Law*”, në datën 01.10.2006, ka lidhur një kontratë pune individuale me shtetasin E.B., për pozicionin “kontabilist” dhe “përgjegjës” të sektorit të financës.

2. Në muajin nëntor të vitit 2012 kërkuesi ka organizuar një udhëtim pune në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me shpenzimet e tij dhe me qëllim forcimin e marrëdhënieve ndërmjet stafit, por shtetasi E.B. nuk ka marrë pjesë. Në datën 19.12.2012 kërkuesi i është drejtuar shtetasit E.B. me kërkesë për rimbursimin e shpenzimeve të udhëtimit, por ai nuk ka pranuar.

3. Në datën 20.12.2012 kërkuesi ka bërë zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës, duke ndërprerë edhe marrëdhënien financiare, me pretendimin se shtetasi E.B. kishte refuzuar të paraqitej në punë. Kërkuesi i ka dorëzuar shtetasit E.B. librezën e punës me shënimin “Largohet nga puna”.

4. Në datën 11.03.2013 shtetasi E.B. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, me objekt: (i) dëmshpërblim me një vit pagë për zgjidhje të menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës; (ii) dëmshpërblim me pagën e dy muajve për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës; (iii) dëmshpërblim me pagën e tre muajve për mosrespektim të afatit të njoftimit të zgjidhjes së kontratës së punës; (iv) shpërblim për vjetërsi në punë me tri paga mujore; (v) pagim të pagës së papaguar për periudhën 01.12.2012-20.12.2012; (vi) pagim të pagës për një javë pushime vjetore për vitin 2012; (vii) pagim për shpërblim vjetor mbi pagën për tre vjetët e fundit të punës për periudhën 2010-2012, në masën e një page mujore për çdo vit kalendarik.

5. Me vendimin nr. 8786, datë 26.07.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e kërkuesit t’i paguajë paditësit ish-punëmarrës: (i) pagën e 8 muajve punë për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës; (ii) pagën e 2 muajve për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës; (iii) pagën e 3 muajve, për mosrespektim të afatit të njoftimit të zgjidhjes së kontratës së punës (iv) pagimin e pagës së papaguar për periudhën 01.12.2012-20.12.2012; (v) pagimin e pagës për një javë pushime vjetore për vitin 2012; (vi) paga referuese për pagimin e dëmshpërblimeve të merret paga e fundit e paditësit në shumën 318,469 lekë në muaj, si dhe rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera. Sipas asaj gjykate, nga dëshmitë e marra nga kolegët e paditësit është vërtetuar se ai nuk është paraqitur në

punë jo me vullnetin e tij, por i ndikuar nga qëndrimi i kërkuesit, i cili i kërkonte pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, në të kundërt paditësi nuk duhej të paraqitej më në punë. Sipas asaj gjykate, për sa kohë konstatohet se nuk janë kryer shkelje nga paditësi punëmarrës, ajo do të marrë në shqyrtim pasojat e zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës nga kërkuesi. Në vijim, ajo gjykatë ka vendosur plotësimin e vendimit të saj dhe pranimin e padisë edhe për një kërkim tjetër, duke detyruar kërkuesin të paguajë paditësin ish-punëmarrës me tri paga mujore si shpërblim për vjetërsi në punë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim palët ndërgjyqëse.

6. Me vendimin nr. 1118, datë 12.05.2015, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë, me arsyetimin se nga provat me dëshmitarë ka rezultuar se i padituri ish-punëmarrës, pas refuzimit për të paguar shpenzimet e udhëtimit, ka bllokuar kodet për numrat e llogarive dhe më pas nuk është paraqitur më në detyrë, me qëllim shmangien e pagesës së detyrimit, ndërkohë që kërkuesi, në mënyrë korrekte, i ka dorëzuar librezën e punës me shënimin “Largohet nga puna”. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs paditësi ish-punëmarrës.

7. Në datën 04.12.2023 kërkuesi është njoftuar nga Gjykata e Lartë për datën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit (13.12.2023) dhe për përbërjen e trupit gjykues. Po në datën 04.12.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për përjashtimin nga shqyrtimi i çështjes të gjyqtarit E.P. Në datën 07.12.2023 gjyqtari E.P. ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, por Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 12.09.2024 të kryetarit të saj, ka vendosur refuzimin e kërkesës për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

8. Me vendimin nr. 00-2024-4494 (614), datë 13.11.2024, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se nga kërkuesi nuk është paraqitur dosja/regjistri i marrëdhënies së punës së paditësit ish-punëmarrës për të evidentuar nëse ai është larguar me dëshirë, siç rezulton e shënuar në librezën e tij të punës. Sipas Gjykatës së Lartë, ky akt do të kishte fuqi provuese nëse librezë e punës do të ishte mbajtur në bazë të regjistrit themeltar të marrëdhënies së punës, ku në kolonën e veçantë të tij të ishte pasqyruar kërkesa e punëmarrësit dhe nënshkrimi përkatës për largimin nga puna. Sipas asaj gjykate, duke qenë se kërkuesi në cilësinë e punëmarrësit që ka barrën e provës nuk ka arritur të provojë me prova të tjera vërtetësinë e shënimit të vendosur në

librezë, përfundimi i nxjerrë nga gjykata e apelit është i pabazuar në ligj dhe në dokumentacionin e administruar në dosjen gjyqësore. Sipas Gjykatës së Lartë, në ndryshim nga gjykata e apelit, gjykata e shkallës së parë ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, ka identifikuar faktet dhe rrethanat e çështjes, ka vlerësuar në mënyrë të balancuar të gjitha provat e administruara dhe të marra në shqyrtim, duke e zgjidhur drejt mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.

9. Në datën 17.03.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në datën 21.05.2026 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e dorëheqjes së një anëtari të Kolegjit të Gjykatës dhe zëvendësimin e tij me një gjyqtar tjetër.

II

Pretendimet e kërkuetit

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për një proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1. *Së drejtës për t'u njoftuar dhe së drejtës së mbrojtjes efektive*, pasi kërkuesi nuk është njoftuar elektronikisht se çështja e tij e caktuar për t'u shqyrtuar në datën 13.12.2023 është shtyrë minimalisht 3 herë, duke i mohuar atij të drejtën për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tij, duke cenuar në këtë mënyrë edhe parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

10.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi në datën 04.12.2023 kërkuesi ka depozituar në Gjykatën e Lartë një kërkesë për përjashtimin nga shqyrtimi i çështjes gjyqtarin E.P., por nuk i është komunikuar asnjë vendimmarrje. Në datën 30.12.2024 kërkuesi i ka kërkuar informacion Gjykatës së Lartë, e cila, me shkresën nr.6477/1, datë 14.01.2025, i ka vënë në dispozicion kërkuetit kërkesën e gjyqtarit E.P. për heqjen dore dhe vendimin e kryetarit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e dorëheqjes, ndërkohë nuk rezulton të ketë një vendimmarrje nga Gjykata e Lartë për kërkesën e kërkuetit për përjashtimin e gjyqtarit E.P.

10.3. *Parimit të paanshmërisë në gjykim*, pasi edhe pse kërkuesi ka parashtruar fakte dhe argumente për një marrëdhënie indirekte konflikti të gjyqtarit E.P. me kërkuetin, Gjykata e Lartë nuk i ka marrë parasysh. Në këto kushte, Gjykata e Lartë kishte detyrimin ligjor

të merrte një vendim për kërkesën e kërkuarit për përjashtimin e gjyqtarit E.P., për më tepër që edhe vetë gjyqtari në fjalë ka kërkuar zëvendësimin e tij.

10.4. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në tejkalim të juridiksionit të saj si gjykatë ligji, pasi në çështjen konkrete ka kryer një vlerësim të fakteve dhe të provave, duke e zgjidhur çështjen në themel. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmban asnjë paragraf ku kjo e fundit të ketë identifikuar dhe arsyetuar zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural nga gjykata e apelit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kolegji evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuarin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

13. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u njoftuar dhe së drejtës së mbrojtjes efektive, së drejtës së aksesit, parimit të paanshmërisë në gjykim dhe parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.

14. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u njoftuar dhe së drejtës së mbrojtjes efektive, pasi nuk është njoftuar elektronikisht se çështja e tij e caktuar për t'u shqyrtuar në datën 13.12.2023 është shtyrë minimalisht 3 herë, duke i mohuar të drejtën për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tij, duke cenuar në këtë mënyrë edhe parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

15. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për t'u njoftuar dhe për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, ndërsa kjo e drejtë, ndër të tjera, i krijon një pale ndërgjyqëse të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 40, datë 14.09.2023; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë të dokumenteve, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes (*shih vendimin nr. 14, datë 21.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në lidhje me procedurat e gjykimit civil në Gjykatën e Lartë, neni 482 i Kodit të Procedurës Civile (KPC), parashikon se shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit. Sipas pikës 3 të këtij neni, sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve, të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit. Njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në mjediset e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit.

17. Gjykata ka theksuar se në çdo çështje të veçantë, duke pasur parasysh edhe të gjithë procedurën që mund të jetë ndjekur, ajo vlerëson nëse një kufizim ose shkelje gjatë kësaj procedure ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e saj dhe ia ka bërë palës të pamundur mbrojtjen dhe zhvillimin e procesit gjyqësor në mënyrë të drejtë (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 7, datë 28.02.2000 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nëpërmjet rekursit të palës kundërshtare në procesin gjyqësor. Me shkresën e fillim muajit dhjetor të vitit 2023, Gjykata e Lartë ka njoftuar kërkuuesin se me vendimin e datës 22.11.2023 ajo gjykatë ka vendosur revokimin e vendimit të saj të datës 04.04.2017 për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe caktimin e seancës në dhomën e këshillimit (pa praninë e palëve) më 13.12.2023, orën në varësi të listës dhe përbërjen e trupit gjykues. Në paragrafin e fundit të njoftimit, Gjykata e Lartë ka njoftuar palët për afatin 15-ditor nga marrja e njoftimit, por jo më vonë se 5 ditë përpara datës së caktuar për shqyrtimin e çështjes, për depozitimin e pretendimeve me shkrim nga palët. Njoftimi i kërkuetit nga Gjykata e Lartë është dërguar në adresën e dhënë nga kërkuesi dhe është nënshkruar për marrje dijeni në datën 04.12.2023. Nga ana tjetër, rezulton se në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “Njoftime për publikun”, “Informacion i çështjeve civile të datës 13.12.2023” për çështjen e kërkuetit nuk ka vendimmarrje, pasi seanca është shtyrë me shpallje për shkak të heqjes dorë të gjyqtarit E.P. Në vijim, në rubrikën “Çështje të ardhura” është dhënë informacion për datën e planifikimit të çështjes (22.10.2024), datën dhe orën e zhvillimit të seancës (06.11.2024) dhe relatorin e çështjes. Më pas ka rezultuar se në rubrikën “Njoftime për publikun”, çështjet e planifikuara për shqyrtim në dhomën e këshillimit në datën 06.11.2024, ku pjesë e trupit gjykues ka qenë gjyqtarja V.K., përfshirë edhe çështjen e kërkuetit, janë shtyrë me njoftimin se shqyrtimi i çështjeve në dhomën e këshillimit shtyhen për në datën 13.11.2024.

19. Për sa më sipër, Kolegji konstaton se kërkuesi ka marrë dijeni për procesin gjyqësor të caktuar fillimisht për t’u zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në datën 13.12.2023, për rrjedhojë ai ka pasur mundësinë të ushtronte të drejtën për të paraqitur parashtrimeve me shkrim ndaj shkaqeve të rekursit të palës kundërshtare në procesin gjyqësor. Po kështu, Gjykata e Lartë ka bërë dhe njoftimin me shpallje për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes pas ndryshimit të trupit gjykues, të caktuar për në datën 06.11.2024 dhe njëkohësisht njoftimin në faqen në internet se disa çështje të planifikuara për në datën 06.11.2024 (përfshirë edhe çështjen e kërkuetit) do të shqyrtohen më 13.11.2024. Nga ana tjetër, mosrishpallja nga Gjykata e Lartë e datës dhe e orës në faqen e saj të internetit (për datën 13.11.2024), ose mungesa e njoftimit në adresën elektronike të kërkuetit sipas përcaktimit të nenit 482, pika 3, të KPC-së, për sa kohë ai ishte njoftuar më parë për shqyrtimin e çështjes më 06.11.2024, nuk përbën shkelje të tillë kushtetuese, ku, si pasojë e saj, kërkuetit t’i jetë cenuar e drejta substanciale e mbrojtjes, për të cilën ai nuk ka sjellë asnjë argument ose provë

për të vërtetuar se në ç' mënyrë i është cenuar ajo. Gjykata e Lartë, nëpërmjet shpalljes në faqen e saj zyrtare të internetit të datës, orës dhe të përbërjes së trupit gjykues, si dhe të shtyrjes së datës së shqyrtimit të çështjes për arsye objektive, sipas përcaktimit të 482, pika 3, të KPC-së, e ka kryer detyrimin saj për garantimin e zhvillimit të një procesi të rregullt në respektim të elementeve të tij. Për këtë arsye, vlen të ritheksohet përsëri qëndrimi i mbajtur edhe më parë prej Gjykatës, se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes të të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017; nr. 30, datë 19.05.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar dhe së drejtës së mbrojtjes efektive është haptazi i pabazuar.

20. Kërkuar ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit, pasi, ndonëse ka depozituar në Gjykatën e Lartë kërkesën për përjashtimin nga shqyrtimi i çështjes të gjyqtarit E.P., atij nuk i është komunikuar asnjë vendimmarrje nga ajo gjykatë. Po kështu, kërkuar ka pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, pasi edhe pse ka parashtruar fakte dhe argumente për një marrëdhënie indirekte konflikti të tij me gjyqtarin E.P., Gjykata e Lartë nuk ka marrë vendim për kërkesën e tij për përjashtimin e gjyqtarit nga shqyrtimi i çështjes. Nisur nga thelbi i pretendimeve, ato do të analizohen në drejtim të parimit të paanshmërisë.

21. Gjykata ka theksuar se respektimi i së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme duhet të verifikohet duke zbatuar në dy teste, testin subjektiv, i cili, në thelb, kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe gjithashtu testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë (*shih vendimet nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 10, datë 13.02.2017; nr. 49, datë 10.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në çështjen në shqyrtim, nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, Kolegji konstaton se kërkuar në datën 04.12.2023 ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit E.P. nga shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, me pretendimin se ka një marrëdhënie indirekte konflikti me të për

shkak të një procesi tjetër gjyqësor ku kërkuesi është përfaqësues ligjor i palës së paditur dhe pala paditëse është familjare e gjyqtarit E.P. Në datën 07.12.2023 gjyqtari E.P. ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, duke parashtruar të njëjtat rrethana me kërkuesin, por duke theksuar se në testin subjektiv ato nuk janë shkak ndikimi në gjykimin e drejtë e të paanshëm të çështjes në të cilën ai është shortuar si gjyqtar. Kjo kërkesë është shqyrtuar nga kryetari i Gjykatës së Lartë, i cili, me vendimin e datës 12.09.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, duke vlerësuar se nuk ka shkaqe të përligjura sipas nenit 72, pika 6, të KPC-së.

23. Për sa më lart, ndonëse kërkesa e kërkuesit për përjashtimin e gjyqtarit E.P. nuk ka marrë përgjigje në mënyrë të drejtpërdrejtë, Kolegji konstaton se kërkesa e gjyqtarit E.P. për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes së kërkuesit i është nënshtruar shqyrtimit sipas ligjit dhe Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje të arsyetuara edhe pretendimeve të tij. Nisur nga kjo, si dhe për sa kohë në ankimin e tij kushtetues individual kërkuesi nuk ka parashtruar ndonjë argument konkret në nivel kushtetues për pretendimin për njëanshmërinë e gjyqtarit E.P. që ka gjykuar çështjen e tij, vetëm fakti se ai ka dhënë një vendim jo në favor të kërkuesit, nuk mund të vërë në dyshim respektimin e parimit të paanshmërisë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për paanshmëri është haptazi i pabazuar.

24. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit të gjyimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në tejkalim të juridiksionit të saj si gjykatë ligji, duke kryer vlerësim të fakteve dhe të provave, duke e zgjidhur çështjen në themel. Sipas kërkuesit, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmban asnjë paragraf ku kjo e fundit të ketë identifikuar dhe arsyetuar zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural nga gjykata e apelit.

25. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj. Ky element, në sensin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik (*shih vendimet nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 3, datë 07.02.2023; nr. 7, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë është theksuar se në ushtrimin e funksionit, si gjykatë e ligjit, ajo gjykatë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe të bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni ose që nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës së faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore, pasi një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj (*shih vendimet nr. 57, datë 09.11.2023; nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 44, datë 19.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se Gjykata e Lartë nuk mund të bëjë ripërcaktim të fakteve bazuar në një vlerësim të ndryshëm të provave të shqyrtuara dhe të vlerësuara nga gjykatat më të ulëta, por mundet që faktin e përcaktuar nga të njëjtat prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit ta cilësojë juridikisht ndryshe dhe ta zgjidhë vetë çështjen në rast se konstaton zbatim të gabuar të ligjit prej tij (*shih vendimet nr. 7, datë 20.02.2024; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë ka pranuar padinë e palës kundërshtare me kërkesin në procesin gjyqësor, me arsyetimin se nga dëshmitë e marra nga kolegë të paditësit është vërtetuar se ai nuk është paraqitur në punë jo me vullnetin e tij, por i ndikuar nga qëndrimi i kërkuarit, i cili i kërkonte pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, në të kundërt të mos paraqitej më në punë. Ndërkohë, gjykata e apelit ka rrëzuar padinë e paditësit me arsyetimin se nga provat me dëshmitarë ka rezultuar se ai, pas refuzimit për të paguar shpenzimet e udhëtimit, ka bllokuar kodet për numrat e llogarive dhe më pas nuk është paraqitur më në detyrë, me qëllim shmangien e pagesës së detyrimit, ndërkohë që, kërkuari në mënyrë korrekte i ka dorëzuar librezën e punës me shënimin “Largohet nga puna”.

28. Në vijim, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se nga kërkuari nuk është paraqitur dosja/regjistri i marrëdhënies së punës së paditësit ish-punëmarrës për të evidentuar nëse

ai është larguar me dëshirë, siç rezulton e shënuar në librezën e tij të punës. Sipas Gjykatës së Lartë, ky akt do të kishte fuqi provuese vetëm nëse librezja e punës është mbajtur në bazë të regjistrit themeltar të marrëdhënies së punës, ku në kolonën e veçantë të tij të jetë pasqyruar kërkesa e punëmarrësit dhe nënshkrimi përkatës për largimin nga puna. Sipas asaj gjykate, duke qenë se kërkuuesi në cilësinë e punëmarrësit që ka barrën e provës nuk ka arritur të provojë me prova të tjera vërtetësinë e shënimit të vendosur në librezë, përfundimi i nxjerrë nga gjykata e apelit është i pabazuar në ligj dhe në dokumentacionin e administruar në dosjen gjyqësore. Sipas Gjykatës së Lartë, në ndryshim nga gjykata e apelit, gjykata e shkallës së parë ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, ka identifikuar faktet dhe rrethanat e çështjes, ka vlerësuar në mënyrë të balancuar të gjitha provat e administruara dhe të marra në shqyrtim, duke e zgjidhur drejt mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.

29. Për sa më lart, Kolegji konstaton se ndonëse në vendimin e saj Gjykata e Lartë ka përmendur argumente të reja, të cilat nuk janë përmendur nga gjykatat e faktit, nuk rezulton që ajo të ketë bërë ripërcaktim të fakteve, pasi në thelb i është referuar të njëjtave rrethana si ato për të cilat kanë arsyetuar gjykatat e faktit. Pra, Gjykata e Lartë, duke argumentuar mbi elementet dhe kushtet thelbësore të largimit nga puna të paditësit, si dhe mbi faktet dhe provat e administruara në proces, ka konkluduar se është i drejtë dhe i bazuar në ligj përfundimi i arritur nga gjykata e shkallës së parë se paditësi nuk është paraqitur në punë jo me vullnetin e tij, por i ndikuar nga qëndrimi i kërkuessit, i cili i kërkonte pagesën e shpenzimeve të udhëtimit në të kundërt nuk duhej të paraqitej më në punë. Në këtë drejtim, nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë ripërcaktuar faktin ose të ketë nxjerrë konkluzion të ndryshëm në raport me atë të gjykatës së shkallës së parë. Sikurse u evidentua më lart, referimi që ajo gjykatë bën në provat e administruara nga gjykatat më të ulëta është në funksion të dhënies së një vendimi të arsyetuar, gjë që provohet edhe nga fakti se Gjykata e Lartë nuk ka tjetërsuar bazat faktike të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, por ka lënë në fuqi këtë të fundit, duke plotësuar arsyetimin e saj. Argumentet e përmendura nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj nuk janë përcaktuese dhe nuk mund të shihen të shkëputura nga provat e vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, por u shërbejnë argumenteve të përdorura në mbështetje të vendimmarrjes së saj. Duke pasur parasysh natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë, është i pashmangshëm referimi në provat gjyqësore për të interpretuar ligjin në përputhje me to. Për

rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

30. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.